

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

Projektvendimin “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2025-2030 dhe planit të veprimit 2025-2028 në zbatim të saj”

1. Titulli i projektaktit

“Për miratimin e strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2025-2030 dhe planit të veprimit 2025-2028 në zbatim të saj”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 6, datë 14.04.2025, u krijua Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025–2028, i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe që në përbërje kishte anëtarë, përfaqësues të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; Ministrisë së Mbrojtjes; Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët; Prokurorisë së Përgjithshme; Strukturës së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit; Agjencisë së Kontrollit Shtetëror të Eksporteve; Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës janë koordinuar dhe bërë pjesë e agjendës së takimeve të Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla e të Lehta një mekanizëm koordinues ndërinstitucional në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 22.05.2017.

Në këtë kuadër takimi kryesor ishte takimi i 13-të i Komisionit Kombëtar i Armëve të Vogla e të Lehta i mbajtur në datë 12 qershor 2025, në ambientet e Hotel Rogner Tiranë, ku pjesë e rëndësishme e agjendës së tij u bë edhe diskutimi i draftit të parë të strategjisë dhe planit të ri veprimit pjesë e projektvendimit të Këshillit të Ministrave nga Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 6, datë

14.04.2025, përfshirë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të përfshira dhe organizatat ndërkombëtare.

Plani i Veprimit i është përcjellë të gjitha organizatave që kanë projekte në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve dhe që financohen dhe mbështesin institucionet shqiptare nën ombrellën e aktiviteteve të Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta në Ballkanin Perëndimor 2025-2030 si UNODC, UNDP, OSBE, SEESAC, më datë 19.06.2025.

Gjithashtu, projektvendimi u publikua në RENJK, për periudhën 10 korrik 2025 deri më 7 gusht 2025, në respektim të afateve ligjore. Projektakti pati 479 shikime në Regjistrin Elektronik dhe 0 komente.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2025-2030 dhe planit të veprimit 2025-2028 në zbatim të saj”, janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrin nr. 6, datë 14.04.2025 “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025 - 2028”;
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike, gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Koordinatori për konsultimin në MPB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK/postë elektronike;
- Qendra për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Evropën Juglindore dhe Lindore (SEESAC);
- Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>Vendimi (pranuar /pranuar pjesërisht/i refuzuar)</i>	<i>Justifikimi</i>